

REPUBLIKA E SHQIPERISË



BASHKIA KRUJË
Këshilli i Bashkisë

Nr. _____ Prot

Krujë më ____/____/2017

VENDIM

Nr. 158 datë 28/12 /2017

“Për miratimin e listave, dokumentave dhe vlerës për dëmet e shkaktuara në familjet e bashkisë Krujë, nga reshjet e shumta dhe përmbytjet prej lumit Zezë e Gjole në datën 01 dhjetor 2017”

Këshilli Bashkisë Krujë në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, ligjit Nr.8756, datë 26.3.2001 “Për Emergjencat Civile”, i përditësuar, ndryshuar me Ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009 dhe në zbatim të pikës III/2 të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi natyrore”, pasi shqyrtoji dokumentacionin e hartuar nga grupet e punës për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në datën 01 dhjetor 2017”, të cilat kapin shumën **230 000 000 (dyqind e tridhjetë milion) lek** dhe me propozim të kryetarit të bashkisë,

VENDOSI:

- 1.Miratimin e listave, dokumentave dhe vlerës për dëmet e shkaktuara në familjet e bashkisë Krujë, nga reshjet e shumta dhe përmbytjet prej lumit Zezë e Gjole në datën 01 dhjetor 2017”.
- 2.Miratimin e kërkesës drejtuar Drejtorisë së Përgjithëshme të Emergjencave Civile për mundësinë e përballimit të efekteve financiare, të këtyre dëmtimeve nga fondet e tyre të emërgjencës, me vlerën **230 000 000 (dyqind e tridhjetë milion) lek**.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Durrës.

**KRYETARI I KËSHILLIT
HYSNI CACA**

**NË MUNGESË
ZËVËNDËSKRYETARI
ARTUR KARAJ**

